



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT
PERMBARUESE GJYQESORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"**

Nr.1542/Prot.

Tiranë, me dt.24/08/2023



**U R D H Ë R
VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE**

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit

TIRANË

Për Dijeni : Debitorit, Ujësjiellës Kanalizime sh.a

Adresa; Blloku Nr.5, Kolonjë

ERSEKË

Për dijeni: Kreditorit, Shoqëria FalcomX sh.p.k

Adresa; Rruga Xhavit Demneri, Pallati Gener 2, Ap.35

TIRANË

Unë, përmbaruese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. çertifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.1804/Regj, bazuar në Urdhrin e Ekzekutimit Vendim Nr.628 UE, datë 07.10.2022, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Korçë,

KONSTATOVA:

Se me datë; 03.08.2023 është depozituar pranë përmbarueses gjyqësore private "Ensola Kuçi", kërkesa e kreditorit Shoqëria "FalcomX" sh.p.k, së bashku me Urdhrin e Ekzekutimit, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Faturë Tatimore 14/2021, datë 18.10.2021, me palë dhe objekt:

Kreditor : Shoqëria "FalcomX" sh.p.k

Debitor : Ujësjiellës Kanalizime sh.a Ersekë

Objekti : Pagim detyrimi

Zyra përmbarimore, në mbështetje të nenit 133 të K. Pr. Civile, ka bërë shpalljen e lajmërimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Megjithëse, pala debitore ka marrë dijeni dhe nuk ka vepruar për shlyerjen e detyrimit sipas afatit të përcaktuar në nenin 517 të K.

Adresa: Rr."Brigada VIII", Pall 8, Hyrja 2, Kati 2, Tiranë Cel.0682000133, email:kuciensola@gmail.com.

Pr. Civile. Për rrjedhojë, në mbështetje të nenit 519 të K. Pr. Civile, ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte, për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv duhet të kryhet bllokimi mbi kuotat/kapitalet e palës debitore Ujësjiellës Kanalizime sh.a Ersekë.

Sa sipër, bazuar në nenin 527 e vijues të K. Pr. Civile;

U R D H Ë R O J;

Vendosjen e masës së sekuestros mbi kuotat/kapitalet e palës debitore **Ujësjiellës Kanalizime sh.a Ersekë me NIPT K275170090**, në mënyrë që të mos kryhet asnjë veprim tjetërsimi apo disponimi.

Sekuestro duhet të vendoset në zbatim të Urdhrit të ekzekutimit Vendim Nr.628 UE, datë 07.10.2022, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Korçë, duke respektuar rradhën e preferimit, bazuar në nenin 605 të K.Civil.

Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Lutemi, gjeni bashkalidhur kopje të Urdhrit të ekzekutimit

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

Ensola S. KUÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr.regj.them.90200-01446-41-2022(628 UE)
Datë regj.06.10.2022

Nr.vendimi 41-2022-2915 (628 UE)
Datë vendimi 07.10.2022

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:
Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI**, asistuar nga sekretare Xhorxhina Vangjel, në gjykatë sot më sot më datë 07.10.2022, morri në shqyrtim pa praninë e palëve, kërkesën civile me palë dhe objekt:

KËRKUES: Shoqëria “FalComX” sh.p.k, me adresë Njësia Bashkiake nr.2, Rr. “Xhavit Shyqyri Demneri”, pallati “Gener 2”, apartamenti 35, Tiranë, regjistruar në QKB me numur unik identifikimi (NUIS) L81604003O, me administrator Dritjon Muçaj.

Debitor: Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime”, sh.a. Ersekë, regjistruar në QKB me numur unik identifikimi (NUIS) K27517009O me administrator Igli Radomi.

OBJEKTI: Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv faturën tatimore të shitjes nr.14/2021, datë 18.10.2021, për detyrimin e papaguar në vlerën 790,440 (shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e dyzet) lek,

BAZA LIGJORE: Nenet 510/e e 511 të K.Pr.Civile dhe neni 16 i ligjit 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregëtare”.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar pa praninë e palëve, gjykata, pasi u njoh me kërkesën dhe aktet bashkëlidhur,

VËREN SE:

Shoqëria “FalComX” sh.p.k, është regjistruar në QKB si person juridik, me numur unik identifikimi (NUIS) L81604003O, me administrator Dritjon Muçaj. Objekt i verimtarisë së saj është në fushën e ndërtimit e turizmit, si studim, projektim, konsulencë, si dhe imprimtimin e tregtimin me shumicë e pakicë të të gjitha mallrave me ose pa akcizë, etj.

Në muajin Tetor 2021, Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime”, sh.a. Ersekë ka blerë nga Shoqëria “FalComX” sh.p.k, tubo e rakorderi ujësjetllësi të dimensioneve të ndryshme, saraçineska të dimensioneve të ndryshme, flanaxha, Ta HOPE, manikota, nipelsa, Hollandeze 1, etj. Palët kanë rënë dakort për çmimin dhe shitësi ka bërë furnizimin e blersit me mallin e porositur dhe çmimi i sendeve të blera ka qënë në shumën 1,090,440 lekë. Për shërbimin e ofruar, kërkuesi ka prerë faturën tatimore të shitjes nr.14-2021, datë 18.10.2021, me vlerë 1,090,440 (një milion e nëntëdhjetë mijë e katërqind e dyzet) lekë. Po kështu, palët kanë rënë dakort që pagesa do të bëhej brenda datës 18.11.2021 në llogarinë bankare të shitësit (kërkuesit) në BKT sh.a. brenda 30 ditëve.

Pas kalimit të afatit, blerësi ka përmbushur pjesërisht detyrimin, duke paguar në favor të shitësit shumën 300,000 lek e cila është derdhur në llogarinë e shitësit në BKT sh.a. më datat 01.12.2021, 10.01.2022 e 23.03.2022, nga 100,000 lek çdo pagesë. Më pas, blerësi ka ndërprerë përmbushjen e detyrimit për pjesën e mbetur prej 790,440 lek dhe kreditori i është

drejtuar me dy kërkesa për përmbushjen e detyrimit por debitori nuk e ka përmbushuar atë. Nisur nga ky fakt, bazuar në nenet 510 e 511 të K.Pr.Civile dhe nenin 16 të ligjit 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregëtare", kërkuesi ka kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për faturën tatimore të shitjes nr.14-2021, datë 18.10.2021, për vlerën e pashlyer 790,440 lek, pasi blerësi nuk ka paguar vlerën e saj.

Gjykata, pasi u njoh me kërkesën, faturën tatimore të shitjes dhe aktet e tjera, konstatoi se shqyrtimi i kësaj çështje i përket juridiksionit gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente nga pikëpamja lëndore e tokësore për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, si gjykata e vendit të ekzekutimit.

Kërkuesi legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, pasi ka cilësinë e kreditorit në lidhje me vlerën e faturës tatimore të shitjes. Neni 510 i K.Pr.Civile, në shkronjën "e" përcakton: *"Jane tituj ekzekutive: e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre"*

Fatura tatimore e shitjes, me debitor "Ujësjetllës Kanalizime", sh.a. Ersekë, sipas ligjit 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregëtare" përbën titull ekzekutiv, pasi pika 1 e nenit 16 të ligjit përcakton: *"Detyrimet monetare të lindura nga veprimet juridike tregëtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i K.Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur: a) Kreditori ka lëvruar mallrat apo ka kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit, dhe b) Debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin"*. Në rastin konkret, jemi para një veprimi juridik midis dy shoqërive të regjistruara si persona juridik në QKB, veprimi është bërë me shkresë dhe konform ligjit, pasi është plotësuar fatura tatimore e shitjes dhe detyrimi është pranuar nga blerësi. Referuar ligjit 48/2014, jemi para një detyrimi tregëtar dhe sipas nenit 510/e të K.Pr.Civile, fatura tatimore e shitjes është titull ekzekutiv.

Kërkuesi i ka lindur e drejta për të kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, pasi nga ana e blerësit (debitorit) nuk është bërë shlyerja e detyrimit dhe në lidhje me këtë të drejtë, rezulton se plotësohen kriteret që parashikon neni 16 i ligjit 48/2014, pasi:

-Kreditori (kërkuesi) ka kryer shërbimin, duke furnizuar Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Ersekë me mallin e porositur, fakt që rezulton nga fatura tatimore e shitjes;

-Nuk rezulton që debitori të ketë kundërshtuar detyrimin megjithëse kanë kaluar mbi 11 muaj nga kryerja e shërbimit. Debitori e ka pranuar atë dhe e ka shlye pjërisht në shumën 300,000 lek dhe nuk ka ngritur ndonjë pretendim.

-Kreditori i është drejtuar me dy kërkesa debitorit, me nr.07 prot, datë 15.07.2022 dhe nr.08 prot, datë 01.09.2022, me të cilat i ka kërkuar përmbushjen në mënyrë vullnetare të detyrimit, si dhe e ka vënë në dijeni se në rast mospërmbushje do të dejtohet gjykatës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, por ai nuk e ka përmbushur detyrimin në vlerën 790,440 lek.

-Shlyerja nuk është bërë brenda afatit të pagesës, për të cilin neni 6/1 i ligjit 48/2014 parashikon: *"Kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, llogaritja e kamatëvonesës fillon nga data, në të cilën debitori nuk ka ekzekutuar detyrimin e tij, të kërkuar nga kreditori, sipas parashikimeve të nenit 463 të Kodit Civil. Kreditorit, të cilit debitori nuk i ka kundërshtuar furnizimin me mallra apo shërbime, i lind e drejta për të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga dita e nesërme pas datës së afatit të pagesës, të përcaktuar në kontratë"*. Në rastin konkret palët kanë rënë dakort që pagesa do të bëhet brenda datës 18.11.2021 (pasqyruar në

faturë) dhe nisur nga ky fakt, kërkuesit i ka lindur e drejta e kërkimit më datë 19.11.2021. Fakti që debitori nuk ka shlyer shumën 790,440 lek rezulton dhe nga statement i Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. në lidhje me lëvizjet (kreditime-debitime) në llogarinë e kërkuesit.

Nisur nga sa më sipër, gjykata vlerëson se, kërkesa duhet të pranohet si e bazuar në prova e në ligj, duke u lëshuar urdhri i ekzekutimit për faturën tatimore të shitjes nr.14-2021, datë 18.10.2021, me vlerë 790,440 (shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e dyzet) lek, me shitës (kreditor) "FalComX" sh.p.k. dhe blerës (debitor) Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Ersekë.

Përsa i përket kamatëvonesave, kërkuesi nuk ka bërë llogaritjen e tyre por pavarësisht këtij fakti, referuar parashikimeve të nenit 4 të ligjit 48/2014, debitori duhet të paguajë kamatvonesat në përputhje me parashikimet e këtij ligji, duke filluar nga dita e nesërme, pas kalimit të afatit për kryerjen e pagesës, data 19.11.2021. Në lidhje me faktin nëse debitori është para rasteve përjashtimore të parashikuara nga neni 485 i K.Civil, gjykata çmon se ky verifikim i përket fazës së ekzekutimit dhe bëhet nga shërbimi përmbartimor gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 510/e, 511 të K.Pr.Civile dhe ligjin 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregëtare"

VENDOSI:

1-Pranimin e kërkesës të personit juridik "FalComX" sh.p.k.me seli në Tiranë.

2-Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv faturën tatimore të shitjes nr.14-2021, datë 18.10.2021, me vlerë 790,440 (shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e dyzet) lek, me shitës (kreditor) "FalComX" sh.p.k. dhe blerës (debitor) Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Ersekë.

3-Debitori, Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Ersekë, duhet të paguajë në favor të kreditorit "FalComX" sh.p.k kamatat ligjore deri në ekzekutimin e detyrimit për shumën 790,440 lek, në përputhje me parashikimin e bërë në ligjin 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregëtare" dhe nenin 511 të K.Pr.Civile, paragrafi i fundit, shkronja "d" e tij, llogaritja e të cilave fillon nga data 19.11.2021.


-Shpenzimet gjyqësore në vlerën 200 lek lihen në ngarkim të kërkuesit.

-Ky vendim është i formës së prerë dhe lëshohet vetëm në një kopje.

-Me ekzekutimin e këtij urdhëri ngarkohet shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror ose privat, sipas kërkesës së kreditorit.

-Korçë, sot më datë 07.10.2022

SEKRETARE
Xhorxhina VANGJEL



PULLE TARIFFE



Grolde Koxli GJYQTARI

Seladin PYSOYLA

